



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

U D H Ë Z I M

NR. 3477, DATË 22.7.2015

“PËR METODOLOGJINË E KLASIFIKIMIT, KODIFIKIMIT DHE FORMULARËT E APLIKIMIT TË SHËRBIMEVE QË OFROHEN NGA ADMINISTRATA SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 24 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës shtetërore, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 943, datë 9.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike”, pika 3, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 22.10.2014 “Për krijimin e Qendrës së Ofritit të Shërbimeve të Integruara”, pika 3, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 27.5.2015, pika 3, Urdhrit të Kryeministrit nr. 236, datë 24.9.2014 “Për ngritjen e grupeve të posaçme të punës për zhvillimin e Qendrës së shërbimeve publike në kuadër të prioritetit qeverisës për reformën në administratën publike për mirëqeverisje inovative”,

U D H Ë Z O J:

I. PARIMET E PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë metodologjinë që duhet të ndiqet nga institucionet e administratës shtetërore në klasifikimin, kodifikimin dhe formularët e aplikimit të shërbimeve publike që ofrohen prej tyre në favor të personave fizikë dhe juridikë, si dhe përcaktimin e institucioneve përgjegjëse.

II. TË DHËNAT E KLASIFIKIMIT

1. Klasifikimi i shërbimeve publike në Shqipëri do të bëhet me tri nivele:

1.1 **Funksioni** - shkalla e parë e klasifikimit, që pasqyron ndarjen tematike sipas ngjarjeve jetësore dhe përfshin grupe shërbimesh.

1.2. **Grupi i shërbimeve** - shkalla e dytë e klasifikimit, që pasqyron një nënndarje të funksionit sipas nëntematikave specifike. Shërbimet që i përkasin një grupi janë të ngjashme midis tyre dhe formojnë një grup, i cili është i dallueshëm nga të tjerët brenda funksionit për shkak të llojit apo qëllimit që ka.

